



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 1004/Prot.
4

Tiranë, më 26.4.2021

VENDIM

Nr. 15, datë 26.04.2021

“Për miratimin e riorganizimit të programit të studimeve të doktoratës në “Shkenca Sociale”, në Fakultetin e Shkencave Sociale të UT-së, për vitin akademik 2021-2022”

Bazuar në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 3, pika 2/b; neni 35, pika 1; neni 38, pika 1/dh; neni 77 dhe neni 91, pika 3; VKM nr. 41, datë 24.01.2018, “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar; Udhëzimin e MASR, nr. 1, datë 14.01.2020 “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degeve të tyre, njërive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë”, i ndryshuar, Kreu IV, gërma “E”; Udhëzimin e MASR, nr. 10, datë 30.03.2020, “Për përcaktimin e elementëve përbërës, formën e diplomës ose certifikatës të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë dhe procedurës së regjistrimit të tyre në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor”, i ndryshuar, Kreu I, pika 2; Statutin e Universitetit të Tiranës, neni 31, gërmat “f” dhe “j”, si dhe në propozimin e përcjellë nga Fakulteti i Shkencave Sociale me shkresën nr. 312/9 Prot., datë 20.04.2021, Senati Akademik i Universitetit të Tiranës, në mbledhjen e datës 26.04.2021,

VENDOSI:

1. Të miratojë riorganizimin e programit të studimeve të doktoratës në “*Shkenca Sociale*” (në fushën e shkencave sociale sipas manualit të FRASCAT-it), në Fakultetin e Shkencave Sociale të Universitetit të Tiranës, sipas nënfishave të mëposhtme:
 - “Psikologji”
 - “Punë Sociale”
 - “Sociologji”
 - “Edukim”
 - “Shkenca Politike”
 - “Filozofi”
2. Të miratojë formën e diplomës, për programin e studimeve të doktoratës, në Fakultetin e Shkencave Sociale të UT-së.
3. Dokumentacioni përkatës t’i përcillet për miratim Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

4. Pas miratimit të MASR-së, sipas pikës 3 të këtij vendimi, dokumentacioni përkatës të përcillet edhe në Qendrën e Shërbimeve Arsimore për regjistrimin e formës së diplomës.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Prof. Dr. Artan Hoxha





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK



Nr. 1019 Prot.

Tiranë, më 26. 4 .2021

1

VENDIM

Nr. 16, datë 26. 04 2021

“Për miratimin paraprak të tarifave të aplikimit dhe studimit për programet e studimeve të doktoratës në Universitetin e Tiranës”

Bazuar në nenin 3, pika 3/ç; nenin 38, pikat 1 dhe 3; nenin 79, pika 5; nenin 98, pika 2/c, të Ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në RSH”; në Seksionin IV, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 75, datë 12.2.2018, “Për miratimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor”; në nenin 7, pika 3/ç; neni 31, gërma u; nenet 98 dhe 99, të Statutit të Universitetit të Tiranës si dhe në propozimin e Administratorit të UT-së, të mbështetur në propozimet e njëjse kryesore, Senati Akademik i Universitetit të Tiranës, në mbledhjen e datës 26.04.2021,

VENDOSI:

1. Të miratojë paraprakisht tarifën e aplikimit për programet e studimeve të doktoratës në vlerën monetare prej 5.000 lekë për program.
2. Të miratojë paraprakisht tarifën e studimit për programet e studimeve të doktoratës në vlerën monetare prej 450.000 lekë për program.
3. Kostot e tjera mbi këtë tarifë financohen nga subjekte të tjera, ose vetëfinancohen nga kandidati për doktorant, sipas marrëveshjes që lidhet me UT-në.
4. Ky vendim t’i përcillet për miratim Bordit të Administrimit të Universitetit Tiranës.



Prof. Dr. Artan Hoxha

Artan Hoxha